

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)  
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 616-26-7284-2-2-1  
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: "Sherbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit"  
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Shoqëria e Avokatëve "AVOKATURA ISTREFI" SH.P.K. me nr. unik id. 810089236**  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. "Bill Clinton", Hyrja 69, Kati 1, Nr. 1**  
(Adresa)

**Prishtinë**  
(Vendi)

**10000**  
(Kodi postar)

**049/166-006; 044/166-006**  
(Numri Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Faks-it)

**Arbër Istrefi**  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**arber@avokaturaistrefi.com**  
(Adresa elektronike)

19.09.2026  
(Data e parashtrimit të ankesës)

  
(Nënshkrimi dhe vula)  
PRISHTINE

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- B05 Njoftimi për kontratë / publikimi i aktivitetit, dt. 28.08.2026;
- Dosja e tenderit, e dt. 28.08.2026;
- Kërkesë për sqarim e OE “Avokatura Istrefi” Sh.P.K., e dt. 07.09.2026;
- B54 Njoftim për informata shtesë - përmirësim i gabimit (përgjigje ndaj sqarimit), publikuar më 14.09.2026 – heqet limiti 50% i tarifores OAK; lihet në fuqi pragu i referencave 150.000 €;
- Kërkesë për rishqyrtim, e dt. 14.09.2026;
- Vendimi i AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim, i dt. 18.09.2026 (REFUZOHET si e pabazuar);
- Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 28.09.2026, ora 14:00;
- Kriteri: Çmimi më i ulët;
- Vlera e shpallur vetëm në e-prokurim: 100.000,00 €.

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

|    |  |  |  |  |    |                                     |  |
|----|--|--|--|--|----|-------------------------------------|--|
| Po |  |  |  |  | Jo | <input checked="" type="checkbox"/> |  |
|----|--|--|--|--|----|-------------------------------------|--|

Hapja e tenderëve nuk është mbajtur. Kjo ankesë ka të bëjë me njoftimin e kontratës dhe me Dosjen e Tenderit, para afatit të dorëzimit të ofertave.

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

|    |  |  |  |  |    |  |  |
|----|--|--|--|--|----|--|--|
| Po |  |  |  |  | Jo |  |  |
|----|--|--|--|--|----|--|--|

|  |
|--|
|  |
|--|

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### I. Shkeljet e LPP-së nga ana e AK-së:

- Neni 1 Qëllimi;
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi;
- Neni 27 Dosja e Tenderit;
- Neni 28 Specifikimet Teknike;
- Neni 53 Ofrimi i informatave shtesë ose sqaruese;
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
- Neni 71 Kriteret e përzgjedhjes;
- Dhe dispozita tjera të LPP-së.

### II. Rregullorja nr. 001/2022, e ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024:

- Neni 24.4 – 24.5 Sqarimi i DT-së;
- Neni 25.17 Kërkesat minimale relevante dhe proporcionale me objektin;
- Neni 17.12 Informatat relevante në DT.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi” Sh.P.K. është operator ekonomik i interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin 616-26-7284-2-2-1. Më 07.09.2026 në e-prokurim kemi parashtruar kërkesë për sqarim të DT-së. Më 14.09.2026, të njëjtën ditë kur parashtruesi ka parashtruar edhe kërkesën për rishqyrtim sipas nenit 108/A, AK (pas 2 ore) ka publikuar B54 – Njoftim për informata shtesë / përmirësim i gabimit. Me atë B54 AK e ka hequr limitin “jo nën 50% të tarifores së OAK”, por e ka lënë në fuqi, dhe e ka riformuluar, kërkesën për referenca “jo me pak se 150.000,00 €” për së paku dy kontrata/referenca. Më 18.09.2026 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar dhe ka lejuar vazhdimin e aktivitetit.

Kërkesa e dt. 14.09.2026 kishte tri kërkesa: mungesën e sqarimit të plotë; pragu e dy referencave në vlerë prej 150.000 € për shërbime të ngjashme; dyshtetësi 50 % të tarifores OAK, ndërsa me Njoftimin B54 të 14.09.2026 pika e fundit – dyshtetësi 50 % është konsumuar pasi AK e ka hequr këtë kriter pas kërkesës sonë për sqarime. Andaj, objekt i kësaj anekse është vendimi i 18.09.2026 dhe kriteri i mbetur i FDT 9.1/9.2, siç është lënë: së paku dy shërbime gjyqësore “jo me pak se 150.000,00 €” (vlera 150.000 € e më shumë duhet të jetë për së paku 2 kontrata/referenca) në 3 vitet e fundit.

Ne si OE, e konsiderojmë të padrejtë këtë kriter, andaj ushtrojmë këtë anekse.

I. Vendimi i dt. 18.09.2026 është i pabazë, ndërsa AK e ngatërron pjesën e hequr me B54 (50%) me pjesën që ka mbetur (150.000 €). Refuzimi “në tërësi” e mbulon mungesën e përgjigjes në sqarime për pragu e referencave, të cilin ne e kemi kundërshtuar që në kërkesën për sqarim të 07.09.2026 dhe në kërkesën për rishqyrtim të 14.09.2026. Në arsyetim AK thotë se referencat janë “absolutisht të domosdoshme” dhe se zyrtari i prokurimit “i ka falur besimin e plotë” njësisë kërkuese. Nenet 10 dhe 11 të RRPP-së rregullojnë ndarjen e punës brenda AK-së. Ato nuk e lirojnë AK-në nga neni 7, 69, 71 i LPP-së dhe neni 25.17 i RRPP-së. “Besimi i njësisë kërkuese” nuk është llogaritje e pragut 150.000 €. B54 tregon se AK e ka pranuar se DT e fillimit ishte e gabuar për 50%; i njëjti standard vlen edhe për pragu 150.000 €, të cilin B54 nuk e ka hequr dhe nuk e ka arsyetuar. Po të analizohet vendimi i atakuar, AK në asnjë pikë nuk e ka argumentuar se mbi çfarë bazë është vendosur ky prag, por mjaftohet vetëm me përshkrimin se “këto kërkesa jo vetëm se janë të ligjshme por edhe janë absolutisht të domosdoshme”.

II. Pragu 150.000 € konsiderojmë se është i kundërligjshëm. Pas B54 të 14.09.2026 ka mbetur kushti që OE të ketë kryer së paku dy shërbime të procedurave gjyqësore në gjykatat e Republikës së Kosovës, “jo me pak se 150.000,00 €”, me sqarimin se vlera 150.000 € e më shumë duhet të jetë për së paku 2 (dy) e më shumë kontrata/referenca në 3 vitet e fundit. Ky kusht është arbitrar sepse nuk është proporcional me objektin dhe me vlerën e kontratës: aktiviteti është kontratë kornizë me çmim njësi, me sasi vetëm indikative dhe pa detyrim blerjeje, ndërsa vlera e shpallur në e-Prokurim është 100.000 €, pra referenca kërkohet mbi vlerën e vetë kontratës. Po në dosje AK kërkon që qarkullimi i tre viteve të fundit të mos jetë më i vogël se 200.000 €. Ky kusht tashmë tregon se zyra e avokatisë ka qarkullim mbi 150.000 € dhe se AK e ka matur seriozitetin ekonomik të OE-së. Të kërkuar mbi këtë edhe së paku dy referenca gjyqësore prej 150.000 € është absolutisht e paarsyeshme dhe i shërben më shumë ndonjë OE-je të caktuar sesa ndonjë dispozite të LPP-së. Ndërsa për kriteret të tilla sqarojmë se AK edhe viteve të kaluara kishte vendosur kushte të tilla diskriminuese duke favorizuar OE të caktuar, mirëpo pas aneksave të vazhdueshme ishte detyruar t’i heqë kriteret diskriminuese dhe në fund ishte anuluar Aktiviteti nga OSHP (Shiqo vendimin OSHP: 2026/0031).

Neni 7 i LPP-së kërkon barazi dhe mosdiskriminim. Nenet 69 dhe 71 kërkojnë që kriteret e

përzgjedhjes të lidhen me objektin dhe të jenë proporcionale. Neni 25.17 i RRPP-së kërkon që kërkesat minimale të kualifikimit të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës. Andaj, ky kriter për së paku dy referenca me vlerë mbi 150,000.00 € e zvogëlon numrin e ofertave të përgjegjshme, dhe mbi të gjitha e kufizon vetëm në disa OE të caktuar duke i pamundësuar OE të tjerë të marrin pjesë në aktivitet.

Vendimi i dt. 18.09.2026 nuk e arsyeton fare shifrën 150.000 €, ashtu sic nuk e arsyeton as B54 por vetëm e riformulon (“jo me pas se” në “jo me pak se”) dhe e lë pragun. I njëjti AK, Komuna e Prishtinës, në vendimet e OSHP-së 2024/0987 dhe 2025/0216 është detyruar të korrigjojë DT-në pikërisht kur kërkesa teknike nuk ishte e lidhur dhe proporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës. As në ato raste OSHP aty nuk e ka pranuar si të mjaftueshme frazën e “domosdoshmërisë”, por ka kërkuar relevancë konkrete.

Kushti mbetet edhe i paqartë edhe pas B54 për shkakun se nuk tregohet qartë nëse 150.000 € është shuma e dy referencave së bashku apo e secilës. Në kuptimin e dytë pragu bëhet 300.000 € kundrejt kornizës 100.000 €. FDT 2.6 thotë se vlera është e shënuar në FDT, mirëpo shuma 100.000 € mungon aty. Andaj konsiderojmë se AK as nuk e ka arsyetuar ligjërisht e teknikisht përse ka vendosur ta ngushton tregun kaq shumë, ngase në një rast të tillë AK duhet të tregojë pse këto dy referenca duke theksuar vlerën mbi 150,000 Euro qenkan të rëndësishme për këtë aktivitet. Në të kaluarën AK Komuna e Prishtinës në vazhdimësi kishte kërkuar nga 4 ose 6 referenca të ngjashme por pa përmendur vlerën e objektit por vetëm natyrën e punës, mirëpo tani AK beson se ka gjetur një formë të re për të kufizuar tregun.

Referenca në avokaturë dëshmon se shërbimi është kryer me profesionalizëm dhe seriozitet, jo qarkullimin e lëndës. Vlera e faturuar shpesh është e vogël ndaj punës së bërë, si të çështjet administrative ku me ligjin e mëparshëm shpenzimet gjyqësore nuk njiheshin (deri në 2025). Prandaj referencat ligjore janë kërkuar gjithmonë me numër shërbimesh të ngjashme e jo me vlerën e faturuar. Duke e kthyer referencën në prag 150.000.00 €, kur serioziteti ekonomik është matuar tashmë me qarkullimin 200.000 €, AK e përjashton OE-në që ka punuar lëndë të vështira por jo të shtrenjta.

Nga ky prag ne si OE kuptojmë se AK po kërkon një OE me shërbime të shtrenjta e jo një OE serioze.

III. Pjesa e 50 % – tanimë e konsumuar me B54, por e rëndësishme për vlerësimin e vendimit, shtojmë se me B54 të 14.09.2026 AK e ka hequr dyshemenë “jo nën 50%”. Neni i cituar fillimisht nga AK i përkiste rregullores së shfuqizuar andaj edhe për këtë pikë kishte tentuar të vendos kritere minimale deri ku mund të aplikohet me cmime minimale, mirëpo neni 4 i Rregullores së tarifave të OAK në fuqi nga 01.01.2026 lejon marrëveshje të lirë. Nuk kërkohet më heqja e 50%, andaj vetëm sqarojmë për OSHP që të vlerësojë B54 si pranim të pjesshëm të kërkesës së OE-së dhe të mos e lejojë AK-në ta përdorë atë ndryshim si arsye për të mbyllur sytë ndaj pragut 150.000 €, të cilin e ka lënë pa arsyetim merititor.

Andaj i propozojmë OSHP-së që të sjellë këtë:

## **VENDIM**

**I. APROVOHET** si e bazuar, ankesa e OE Shoqëria e Avokatëve “AVOKATURA ISTREFI” SH.P.K. kundër Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës të datës 18.09.2026, lidhur me aktivitetin “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit”, nr. i

prokurimit 616-26-7284-2-2-1.

**II. ANULOHE**T pika I dhe II e vendimit të 18.09.2026.

**III. DETYROHET** Autoriteti Kontraktues të publikojë njoftimin për informata shtesë / korrigjim dhe versionin e korrigjuar të Dosjes së Tenderit, duke hequr ose zëvendësuar kërkesën e FDT 9.1/9.2, siç është lënë pas B54 të 14.09.2026, për së paku dy shërbime gjyqësore “jo me pak se 150.000,00 €”, me kërkesë proporcionale – numër referencash të ngjashme, pa prag vleror mbi vlerën e kontratës – si dhe duke shënuar në FDT vlerën e parashikuar 100.000,00 €.

**IV. DETYROHET** Autoriteti Kontraktues të zgjasë afatin e dorëzimit të tenderëve pas publikimit të DT-së së korrigjuar.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Nëse pragu 150.000 € mbetet, parashtruesi ose nuk mund të ofertojë ose rrezikon eliminim për mosplotësim të një kushti joproporcional.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.